



**Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Anëtarësime e Universitetit Publik
"Kadri Zeka", Gjiilan,**

shpall këtë:

**Thirrje për aplikime për shkëmbim studentor/semestral
në Universitetin "Kastamonu University", Turqi**

Universiteti Publik "Kadri Zeka", është pjesë e projektit KA171 ICM, 2022-2023, Erasmus+, në partneritet me Universitetin e Kastamonu University në Kastamonu, Turqi.

Programi Erasmus + KA171 ose shkëmbimi afatshkurtër dhe afatgjatë i studentëve (ICM) është një program i mobilitetit plotësisht i financuar nga projekti që mundëson shkëmbimin e studentëve, stafit mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës midis Universitetit të Kastamonu University në Kastamonu nga Turqia dhe Universitetit Publik "Kadri Zeka", Gjiilan.

ICM Erasmus + mundëson shkëmbimin e studentëve nga Universiteti "Kadri Zeka" – Gjiilan për studim dhe trajnim / veprimtari të lëvizjes në fusha të ndryshme, studentëve u mundësohet që një semestër ta përfundojnë në Universitetin e Kastamonu University nga Turqia.

Mundësi aplikimi kanë studentët nga Fakulteti Edukimit, Fakulteti Shkencave Kompjuterike, Fakulteti Ekonomik, nga të gjitha fakultetet vlenë thirrja për nivelin Bachelor si dhe për nivelin Master.

Në këtë thirrje do të pranohet një(1) studentë. Mobiliteti semestral duhet të realizohet gjatë semestrit të pranverës, viti akademik 2024-2025 nga ndërmjet datave 17 shkurt 2025 deri më 13 korrik 2025. (Mobiliteti zgjat 90 ditë)

Të gjitha shpenzimet janë të mbuluar nga projekti në Universitetin pritës.

Shënim:

- 1) Të gjithë pjesëmarrësit duhet t'i përmbahen kufizimeve të alokuara buxhetore pasi që nuk ka fonde shtesë.
- 2) Buxheti i udhëtimit llogaritet sipas llogaritësit të udhëtimit dhe edhe nëse tarifa e biletës tejkalon shumën e mbështetjes së udhëtimit, nuk mund të jepen fonde shtesë për pjesëmarrësit.



Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Certifikata e notave;
- CV (në gjuhën angleze);
- Një letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim studenti (i lëshuar nga fakulteti juaj që konfirmon nivelin tuaj dhe vitin e studimit gjatë këtij viti akademik, jo më të vjetër se 30 ditë);
- Kopje e pasaportës (faqja që përmban emrin tuaj, fotografinë dhe të dhënat personale) ose Letërnjoftimit;
- Certifikata e gjuhës angleze;

Programet e ofruara në këtë mobilitet do të ofrohen në gjuhën angleze dhe si rrjedhojë kërkohet njohja e gjuhës angleze.

1. Studenti duhet të ketë të përfunduar të paktën 1 semestër në programin në të cilin janë regjistruar. Deri në ditën e fundit për aplikim, studentët të cilët kanë notë mesatare mbi 8.00 llogaritet si përparësi në aplikim.
- 2). Që studentët të marrin një grant të ICM-se, ata duhet të kalojnë të paktën një semester (3 muaj) në universitetin pritës. Granti i mobilitetit të studenteve të ICM mbulon minimumi 90 dite.
- 3). Studentët që do të marrin pjesë në programet e mobilitetit janë të obliguar të përfundojnë lëndë nga universiteti pritës në vlerën e ECTS-ve të kërkuara (rreth 5 kurse).

Vlerësimi i aplikantëve:

- Mesatarja e notës: 50%
- Gjuhë e huaj: 50%

PROCEDURA E APLIKIMIT

- Aplikimet duhet të dorëzohen në Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Anëtarësime (kopje fizike), në mes të datave 30.10.2024 deri 10.11.2024.

Aplikimet e vonuara nuk do të pranohen.

- Rezultatet e aplikimit do të shpallen në www.uni-gjilan.net

Për çdo informatë shtesë, kontaktoni zyrën për bashkëpunim ndërkombëtar në UKZ.

Me respekt,

Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka
Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte